



MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Planet Vendore, Gjermani: Vitin e ardhshëm mbështetje financiare për 18 bashki

2017-04-21 13:13:00



Ministrja e Zhvillimit Urban, znj. Eglantina Gjermani, mori pjesë sot, në takim të parë kombëtar mbi krijimin e rrjetit të bashkëpunësorëve "BRIGAD", organizuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me Ambasadën e Vendeve të Ulta në Tiranë.

Qëllimi i projektit "Brigaid" është përthithja e ideve inovative mbi tre komponente kryesore të ndryshimeve klimatike si: përmblytjet, thatësirat dhe moti ekstrem, një nismë kjo që lidh inovatorët, kërkuesit, akademinë, njerëzit me ide, me institucionet, nëpërmjet disa produkteve që japin zgjidhje praktike e të shpejta në situatat e katastrofave.

Në fjalën e saj, Ministrja Gjermani u shpreh se, në këtë mandat të parë qeverisë reformat që janë ndërmarrë në kuadër të planifikimit kombëtar dhe vendor apo dhe zbatimit të projekteve konkrete siç është dhe rasti i Projektit BRIGAD, formësojnë vizionin "Shqipëria 2030". Konkretisht, të tre planet kombëtare të miratuara tashmë prej mëse një viti, ofrojnë piketat për hartimin e projekteve konkrete strategjike, që garantojnë menaxhimin racional të tokës dhe burimeve natyrore, si dhe harmonizimin e të gjithë faktorëve që ndikojnë në jetën social-ekonomike të qytetarëve. Sipas saj, qoftë tre planet kombëtare, si dhe planet vendore që brenda vitit 2017 do të jenë të hartuara për 43 bashki dhe brenda vitit 2018, ne angazhohemi ta përmbylim këtë proces edhe për 18 bashkitë e tjera, përcaktojnë qartazi zhvillimin që do të marrë territori në 15 vitet e ardhshme në shërbim të rritjes së sektorëve kryesorë të ekonomisë kombëtare si turizmi, bujqësia, energjitika, transporti.

Për të mos e lënë hartimin e instrumenteve të planifikimit vetëm në nivel kombëtar kjo Qeveri ndërmori dhe një tjetër nismë që i vjen në ndihmë bashkive për të pasur të hartuar dhe miratuar planet e tyre vendore.

Gjithashtu këto instrumente shërbejnë si amortizator për të minimizuar faktorët që sjellin ndryshimet klimatike si erozioni, eficienta e energjisë apo emetimet e dioksidit të karbonit për lëvizjet alternative.

Ndër të tjera këto plane kanë të inkuoruar edhe instrumente të rëndësishme që garantojnë mbrojtjen e mjedisit me fokus të veçantë zonat e mbrojtura, kohezionin social dhe zhvillimin e integruar urban dhe rural.

Aktualisht sipërfaqja e zonave të mbrojtura të Shqipërisë është 15% e territorit kombëtar. Gjithashtu Shqipëria bën pjesë në korridorin e Gjellbërt Europian ndaj dhe përgjegjësia jonë për ruajtjen dhe promovimin e këtyre artefakteve natyrore është akoma më e madhe. Ndaj dhe përfshirja e ndryshimeve klimaterike në instrumentat e planifikimit dhe politikave të zhvillimit urban është një komponent i rëndësishëm për të garantuar një **zhvillim të qëndrueshëm** mjedisor, social dhe ekonomik të vendit.

"Duke e parë edhe në këtë aspekt, ky projekt do të jetë edhe një vlerë e shtuar për të gjithë instrumentat e planifikimit në rang

kombëtar dhe vendor”, u shpreh znj. Gjermeni.
E pranishme në këtë takim, ishte edhe Ambasadorja e Vendeve të
Ulëta në Tiranë, znj. **Dewi Van De Weerd**.